



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL

Nr. 52701-01701-00-2015 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2016-2040 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

| | |
|-----------------|----------|
| Edmond Islamaj | Kryesues |
| Artan Zeneli | Anetar |
| Tom Ndreca | Anetar |
| Shkelzen Selimi | Anetar |
| Guxim Zenelaj | Anetar |

Në dhomën e këshillimit të datës 24/11/2016 mori në shqyrtim çështjen penale që i përket:

KËRKUES: PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PA

I PANDEHURI: ALTIN ÇOKU

AKUZA:

Shtrengimit me ane te kanosjes ose dhune per dhenien e pasurise.

BAZA LIGJORE: neni 109/b/1 i K.Penal

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin nr. 62, datë 18.05.2015, ka vendosur:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Altin Pal Çoku, për veprën penale të "Shtrengim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë, vepër kjo e parashikuar nga neni 109/b, paragrafi i parë i Kodit Penal dhe dënimit të tij 2(dy)vjet e 3(tre) muaj burgim.
2. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit dhe **përfundimisht i pandehuri, Altin Pal Çoku, dënohet me 1 (një)vit e 6 (gjashte) muaj burgim.**

- 1.Lënien në fuqi të vendimit nr. 62 datë 18.05.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përse i përket cilësimit ligjor, deklarimit fajtor dhe masën e dënimit të të pandehurit Altin Çoku, për veprën penale të "Shtrengimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë"e parashikuar nga neni 109 germa "b"/I të Kodit Penal.

2- Ndryshimin e vendimit të mësipërm të Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë si më poshtë:

Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal **pezullimin e ekzekutimit të dënimit të mbetur, me burgim dhe vënien në provë të tij për një afat prej 5 vitesh**, duke u urdhëruar i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin Rajonal të Provës, i cili detyrohet të mbikëqyrë ekzekutimin e këtij vendimi.

3-Në zbatim të nenit 60 pika 7, 11 e Kodit Penal detyrohet i dënuari i vënë në prove, të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike, ti nënshtrohet një programi të trajtimit mjekësor apo rehabilitues.

-Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit Altin Çoku, nga dhomat e paraburgimit nëse nuk mbahet për ndonjë shkak tjetër, bazuar në nenin 389 të K.Pr.Penale

Kundër vendimit më datë 24.07.2015, ka paraqitur rekurs Prokurori i Krimeve të Rënda Tiranë, me anën e të cilit ka kërkuar: *Prishjen e vendimit nr:77,date 15.07.2015, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr.62 datë 18.05.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.*

duke parashtruar si shkaqe përkatësisht:

Vendimi i gjykatës së apelit është në kundërshtim me ligjin sepse:

- Vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda është rrjedhojë e zbatimit të gabuar dhe mosrespektimit të ligjit penal.

-Vendimi i gjykatës se Apelit për pjesën që ka ndryshuar vendimin për aplikimin e nenit 59 të K.Penal vjen ndesh me provat e administruara në këtë gjykim. Vendimi i gjykatës se faktit ka qene plotësisht i drejte e bazuar në ligj.

- Në interpretim të kësaj dispozite, rezulton se, në mënyrë që, ndaj një të pandehuri, të vendoset pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, duke u vënë i pandehuri në provë, duhet të ekzistojnë disa rrethana.Kjo formë alternative e vuajtjes së dënimit me burgim aplikohet kur plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte: Së pari: Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor i pandehuri duhet të dënohet jo më shumë se pesë vjet burgim. Kusht, i cili në rastin konkret plotësohet - pasi ndaj të pandehurit, gjykata ka vendosur dënimin e tij me 2 (dy) vjet e 3 (tre) muaj ,burgim dhe duke aplikuar edhe Nenin 406/1 të K.Pr.Penale është dhënë dënimi përfundimtar me 1 (një) vit e (gjashte) muaj burgim.

- Nga formulimi i nenit 59 të Kodit Penal rezulton se këto rrethana janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën.

Duke ju referuar rrethanave të faktit5ato arsimore,profesionale apo ato familjare të të pandehurit,si dhe ato shëndetësore, duke vlerësuar drejt në raport me rrezikshmërinë shoqërore të autorit ,të veprës penale,menyren e kryerjes se veprës, nuk identifikohet asnjë prej kushteve të veçanta të parashikuara nga neni 59 i Kodit Penal.

-Sipas,aktit të Ekspertimit Psikiatriko-ligjor nr.291, datë 29.07.2014, mbi ekzaminimin e shtetasit Pal Çoku, i Insituti i Mjekësisë Ligjore rezulton se;"Shtetasi Altin Çoku vuan nga Kifo scoliosis deformans, Insuficience respiratore restriktive si dhe prezanton tipare të personalitetit narcistik.Në kushtet aktuale nuk prezanton nevojën e ndonjë mase mjekësore, pasi gjykimi dhe të menduarit e sjellja janë brenda tipareve të tij të personalitetit

duke prezantuar një model mbi të cilën funksionon që prej adoleshencës dhe rinisë së hershme.

- Bazuar në provat e administruara dhe, në përgjithësi në aktet që ndodhen në fashikullin e gjykimit, vendimi gjykatës se Apelit është i gabuar vetme për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 433 të K.Pr.Penale,

VËREN

Rezulton se palët kanë dijeni për rekursin.

Rekursi i ushtruar nga **Prokurori i Apelit Për Krime të Rënda** nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i K.Pr.Penale.

PËR KËTO ARSYE

Pasi dëgjoji relacionin përkatës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VENDOSI

Mospranimin e rekursit të ushtruar nga **Prokurori i Apelit Për Krime të Rënda**, kundër vendimit **nr.77, datë 15.07.2015**, të Gjykatës së Apelit Për Krime të Rënda.

Tiranë, më 24/11/2016

Anetar:

Artan Zeneli

Anetar:

Shkelzen Selimi

Anetar:

Guxim Zenelaj

Anetar:

Tom Ndreca

Kryesues:

Edmond Islamaj